



EKSPERTIMI I DETYRUESHËM

Fatmir Tartale

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Tiranë

Adresë kontakti: fatmirtartale@gmail.com

Përmbledhje

Ekspertimi si një nga llojet e provave, parashikohet në kreun e dytë, seksioni 6 i Kodit të Procedurës Penale Shqiptare 1). Natyrisht duke e parë këtë lloj prove, në raport me përcaktimet e bëra në Kodet e Procedurës Penale të shumë vendeve të huaja, në përgjithësi, nga ana e legjislatorit është mbajtur i njëjti qëndrim. Ndërsa, për sa i përket ekspertimit të detyrueshëm, në legjislacionin e sotëm procedural penal shqiptar, nuk parashikohet si një dispozitë e posaçme, kur një sërë kodesh të procedurave penale të huaja, e parashikojnë atë. Kjo kërkesë ka ardhur, si rrjedhojë e nevojave të diktuarra, nga praktika e organeve të procedimit penal.

Duke iu referuar ekspertimit të detyrueshëm, ai është parë në planin krahasues si të legjislacionit shqiptar, gjatë zhvillimit historik të tij dhe të legjislacioneve të një sërë vendesh të huaja, si edhe të mendimit juridik shqiptar e të huaj.

Caktimi i ekspertimit, në çdo rast, është në vartësi të karakterit të rrethanave të konstatuara në çështjen dhe të provuarit të tyre, d.m.th. se ai kushtëzohet jo nga qëndrimi subjektiv i subjekteve të të provuarit, por nga veçoritë objektive të çështjes. Sikurse theksuam, në çdo rast, që hetimi ose shqyrtimi gjyqësor i çështjes shtron kërkesën e konstatimit të fakteve ose sqarimit të tyre, mbi bazën e zbatimit të njohurive të veçanta nga fushat e veçanta të dijes, sipas fazave të zhvillimit të procedimit penal, oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori, gjatë ndjekjes penale ose gjykata gjatë gjykimit, kanë për detyrë të caktojnë ekspertimin.

Fjalë çelës: *Ekspertizë, kodi shqiptar i procedurës penale, procedurë penale, vendim, legal, prokuror, gjyq, rrethana, çështje.*

COMPULSORY EXPERTISE

Abstract

Expertise as a type of proof is presented in the second chapter, session 6 of the Albanian Criminal Procedure Code 1). Observing how the definition of this type of proof is treated by the Codes of Criminal Procedure of many foreign countries, it can be concluded that the approach is similar across the board.

On the other hand, the compulsory expertise is not presented as a separate provision in the Albanian Criminal Procedure Code, while it is in other Criminal Procedure Codes of other countries. This has happened due to the needs dictated from the practice of institutions of criminal procedure.

The analysis of the compulsory expertise has been performed with the lance of historical development of the Albanian legislation as well as foreign countries legislations. The analysis includes both local and foreign legal reflections.

The decision of performing an expertise is in all cases dependent on the specific circumstances, observed for the case and their proof. This means that the expertise is not dependant on a subjective approach of proving the circumstances, but from the objective features of the case.

As we emphasized when the investigation or the judicial review of the case makes a request to find the facts or clarify them with specific knowledge on specific knowledge fields, based on the development phases of the criminal lawsuit, the judicial police officer and the prosecutor should make the decision on the expertise during the prosecution, or this could be done also by the court during the trial.

Key words: *Expertise, Albanian Criminal Procedure Code, criminal procedure, decision, judicial, prosecutor, trial, circumstances, case.*

Zbatimi me rigorozitet i këtij rregulli, nga organet e procedimit, në caktimin e detyrueshëm të ekspertimit, në lloje të veprave penale të caktuara, ka rëndësi të veçantë për konstatimin e së vërtetës. Në qoftë se, për sqarimin e rrethanave që kanë rëndësi për çështjen, bëhet i nevojshëm zbatimi i njohurive të veçanta të shkencës, ndërsa prokurori ose gjykata këtë kërkesë e kupton si diçka fakultative, jo mbi bazën e caktimit të ekspertimit, por sipas vlerësimit të tij, kjo në praktikë, duke mos i dhënë zgjidhje konstatimit të faktit, në mënyrë të pashmangshme, do të shpinte në mosrespektimin e parimit të hetimit të plotë, të gjithanshëm e objektiv, e për rrjedhojë, në mosrealizimin e funksionit të dhënies së drejtësisë.

Duke iu referuar legjislacionit procedural penal të mëparshëm dhe veçorive konkrete të disa çështjeve penale, del se është e nevojshme, që në një numër rastesh, kryerja e ekspertimit të jetë e detyrueshme. Në përputhje me Nenin 68 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953, 2) këto ekspertime kryhen me qëllimin: a) për të konstatuar shkaqet e vdekjes dhe rëndësinë e plagëve. b) kur gjykata ka dyshime për të konstatuar moshën e vogël të të pandehurit, në rastet kur kjo ka rëndësi për çështjen dhe dokumentet për këtë nuk janë bindëse, c) për të përcaktuar gjendjen psikike të të pandehurit, në rastet kur lindin dyshime për përgjegjësinë e tij, ç) për konstatimin e pjekurisë seksuale të të dëmtuarit në krimet e marrëdhënieve seksuale.

Kodet e Procedurës Penale të viteve 1979, 1981, 1995, në ndryshim nga ai i vitit 1953 (neni 68 i tij), nuk i parashikojnë drejtpërsëdrejti këto raste.

Përafërsisht këtë përcaktim që kemi në nenin 178 të Kodit të Procedurës Penale të sotëm, 3) e kanë të definuar me specifikat e veta edhe kodet e procedurës penale të Francës 4), Zvicrës, 5) Gjermanisë, 6) Italisë, 7) Greqisë, 8) Rusisë, 9) etj.

Ndërsa për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në nenin 68 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1953, në këto kode janë përcaktuar një sërë rastesh, kur kryhet ekspertimi i detyrueshëm dhe detyrimet e ekspertit. Në këto kode ekspertimi i detyrueshëm sipas vendit është përcaktuar për rastet e vdekjeve të papritura, për pjekurinë seksuale, për moshën e fëmijës së porsalindur, për falsifikimin e dokumenteve në rastet e vjedhjeve të vlerave monetare etj. Në Kodin e Procedurës Penale të Bullgarisë të vitit 2004, në nenin 117 i tij parashikohet ekspertimi i detyrueshëm për rastet kur ekziston dyshim rreth arsyes së vdekjes, shkallës së plagosjes, gjendjes psikike të të pandehurit, për të kuptuar fakte që kanë rëndësi për çështjen, mundësinë e dëshmitarit lidhur me gjendjen e tij fizike e psikike, kur deklarohen për fakte me rëndësi në lidhje me çështjen dhe mund të japë dëshmi të besueshme për to. 10) Edhe po t'i referohemi Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, miratuar në vitin 2013, atje janë parashikuar një sërë ekspertimesh si ai toksikologjik, neni 143, i lëndimeve trupore, dhe ai fizik, neni 144, molekulare dhe analizat e ADN-së, neni 145, psikologjik, neni 146, kompjuterik, neni 147 dhe ekspertimi financiar, neni 148 të këtij Kodi të Procedurës Penale. 11) Veç përcaktimit në Kodet e Procedurës Penale të huaja, të ekspertimit të detyrueshëm, edhe ekspertë të ligjit kanë shprehur mendimet e tyre, për nevojën e kryerjes së ekspertimit të detyrueshëm, me të cilët jemi të

një mendimi.

Kështu CHARLES E O'HARA dhe GREGORI L'OHARA janë shprehur në "Fundamentals of Criminal Investigation", për ekspertimin e detyrueshëm kur flasin për kryerjen e autopsisë ku shprehen: "Si rregull i përgjithshëm një autopsi që duhet të kryhet, në çdo vdekje, kur ka dyshim vrasje (përfshirë edhe vetëvrasjet). Veçanërisht tipet e mëposhtme të vdekjeve, duhet të jenë objekt ekzaminimi paraprak nga mjeku: vdekjet nga dhuna kriminale, vdekjet aksidentale, vetëvrasjet, vdekjet e papritura, kur viktimat kishte qenë në dukje me shëndet të mirë, vdekjet e pandjekura nga një mjek, vdekjet e ndodhura në burg dhe vdekjet e ndodhura në ndonjë mënyrë të dyshimtë ose të jashtëzakonshme". 12) Për domosdoshmërinë e kryerjes së ekspertimeve mjeko-ligjore, po t'i referohemi nenit 60 të Kodit të Procedurës Penale Franceze, në të është parashikuar kryerja e domosdoshme e një ekspertimi të tillë. Jean Pradel, Profesor i Universitetit të së Drejtës dhe të Shkencave Sociale, është shprehur se: "në përgjithësi i drejtohem një mjeku, në rast se zbulohet një kufomë dhe shkaqet e vdekjes janë të panjohura ose të dyshimta". 13) Praktika e organeve të procedimit penal, si ato të hetimit paraprak dhe e organeve gjyqësore, ka vërtetuar se ekspertimet në drejtim të përcaktimit të shkaqeve të vdekjes, të shkaqeve të dëmtimeve, mjeteve që kanë shkaktuar dëmtimet, përcaktimi i gjendjes psikike të të pandehurit, në rastet kur lindin dyshime për përgjegjësinë e tij, arritja ose mosarritja e pjekurisë seksuale në krimet seksuale, për fëmijët e zënë, vërtetimi veçanërisht i moshës së tij, i ADN-së, aftësitë për të jetuar jashtë trupit të nënës dhe shkakun e vdekjes në rastet e ekzistencës së dyshimit të helmimit, përcaktimi e vërtetimi i llojit, sasisë dhe efektit të helmit të përdorur, atij financiar, kompjuterik në krimet e vjedhjeve apo përdorimit të kompjuterëve në kryerjen e krimeve të ndryshme të parashikuara sipas kodeve penale të çdo vendi, në rastet e ngjarjeve me eksploziv, dëmtimeve të pasurisë me anë të zjarrit, janë gjithmonë të zbatueshme. Kjo do të thotë, se rrethanat e treguara më sipër, duhet të konstatohen vetëm me ndihmën e ekspertimit dhe jo nëpërmjet provave të tjera (p.sh., nëpërmjet shpjegimeve të dëshmitarëve), të cilat në këto raste mund të shërbejnë vetëm si material për ekspertimin ose si material për të verifikuar, organi i ngarkuar me hetimin paraprak, prokurorit ose gjykata, mendimin e ekspertit, por që vepra penale e ndodhur, detyrimisht kërkon caktimin e ekspertit për të kryer, domosdoshmërisht, një nga ekspertimet që është i nevojshëm dhe i domosdoshëm, për të zbuluar një fakt të caktuar, që ka të bëjë me veprën penale të ndodhur dhe autorin apo autorët e saj, si i vetmi dëshmitar, që zbulon atë dhe do t'ia bëjë prezent prokurorit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe gjykatës në seancën gjyqësore, kur të shqyrtohen provat.

Zbatimi i detyrueshëm i ekspertimit nuk është një kërkesë formale, por kusht i domosdoshëm për konstatimin e fakteve. Njohja, për shembull, e shkaqeve të vdekjes ose e rëndësisë së plagëve etj. nuk mund të realizohet ndryshe veçse mbi bazën e caktimit të ekspertimeve mjeko-ligjore. Në këtë rrugë ka ecur edhe praktika e organeve të hetimit paraprak dhe ajo gjyqësore.

Caktimi i detyrueshëm i ekspertimeve sipas rrethanave të treguara, nuk është një veprim arbitrar, por një veprim që duhet, për çdo rast, të gjejë një argumentim mbi një bazë objektive. Jashtë ekzistencës të së dhënës që kushtëzon nevojën e njohurive të posaçme nga fusha e shkencës dhe teknikës, kryerja e ekspertizës do të ishte një veprim i pa argumentuar. Në këtë kuptim, mendojmë se nuk është i drejtë mendimi që për çdo vrasje të kryer, pavarësisht nga ekzistenca ose mungesa e të dhënës, urdhërohet kryerja e detyrueshme e ekspertimit psikiatrik, lidhur me konstatimin e gjendjes psikike të të pandehurit. Mendojmë se për këto raste, ashtu si dhe për çdo vepër tjetër penale, kryerja e ekspertimit psikiatrik i të pandehurit, do të ishte i detyrueshëm, kur para organit të hetimit paraprak prokurorit ose gjykatës lindin dyshime rreth gjendjes psikike të tij.

Duke përcaktuar bazat për kryerjen e detyrueshme të ekspertimeve, legjislativi proceduralo-penal cakton një kriter të qëndrueshëm të praktikës në zbatimin nga organi i procedimit dhe gjykata të ekspertimeve. Ndërkaq, jashtë kritereve të treguara mbi caktimin e detyrueshëm të ekspertimeve, praktika hetimore dhe gjyqësore ka raste që paraqitet e lëkundshme në zgjidhjen e problemit, se çfarë duhet të kuptojmë me njohuri të posaçme, zbatimi i domosdoshëm i të cilave, duhet të shpjerë në caktimin e detyrueshëm të ekspertimit.

Për këtë problem, në praktikë diktohen dy qëndrime të kundërta. Njëri prej tyre të shpie, pa asnjë bazë, në zgjerimin e rrethit të rrethanave për konstatimin e të cilave duhet të caktohet ekspertimi, ndërsa tjetri qëndrim në ngushtimin e tyre.

Qëndrimi i parë është veçori, posaçërisht, për çështjet e ngjarjeve automobilistike dhe të çështjeve të armëmbajtjes pa leje. Në rast se zbulimi i shkaqeve të ngjarjes automobilistike nuk kërkon përdorimin e njohurive teknike (gjendja e dehur e drejtuesit të automjetit, dhënia e automjetit një personi tjetër etj.). në këto raste kryerja e ekspertimeve teknike automobilistike do të ishte një veprim e tepërt, për shkak se përmbajtja e shkeljes së rregullave të qarkullimit nga shoferi, është e kuptueshme për të gjithë dhe zbatimi i këtyre rregullave, për çmuarjen e qëndrimeve të shoferit, mund të realizohen nga vetë prokurori ose gjykata. Mendojmë se nuk ka asnjë bazë për caktimin e ekspertimit dhe në ato raste kur rrethana që duhet të konstatohet, është konstatuar me siguri në mënyrë të plotë, me ndihmën e provave të tjera të mbledhura në çështjen (me përjashtim të rasteve kur caktimi i ekspertimit është i detyrueshëm). Për shembull, nuk ka asnjë kuptim, që të realizohet ekzaminimi kriminalistik i gjurmëve, me qëllim që të konstatohet fakti i qenies së të pandehurit në vendin e ngjarjes, në qoftë se ky fakt jashtë çdo dyshimi, është konstatuar nga shumë dëshmitarë okularë, nga thëniet e vetë të pandehurit etj. ndërkaq, kur ekziston qoftë dhe dyshimi më i vogël ose parashikimi se ky dyshim mund të shfaqet në gjykatë, caktimi i ekspertimit në njërin dhe tjetrin rast, duhet të jetë i detyrueshëm.

Duhet të kemi parasysh se të provuarit e të njëjtës rrethane, nëpërmjet mjeteve procedurale të ndryshme, krijojnë garanci plotësuese kundër gabimeve të mundshme. Gjithashtu duhet të kemi parasysh, se dëshira për të përdorur ekspertimin si mjet të provuari mund të jetë e pamundshme, si pasojë e humbjes ose dëmtimit të gjurmës dhe provave të tjera. Këto veçori përcaktojnë se problemi i caktimit të ekspertimit, mund të zgjidhet drejt, mbi bazën e një çmuarje të thellë e të gjithanshme të provave, duke pasur parasysh perspektivën e hetimit, e më tej, të gjyqimit.

Praktika tregon, se rrezikshmëri më të madhe, për hetimin dhe shqyrtimin gjyqësor të çështjes, paraqet tendenca sipas të cilës, pavarësisht nga ekzistenca e bazave të nevojshme, ekspertimi në çështjen nuk caktohet, ose realizohet, në kohë jo të duhur. Shpesh herë kjo ndodh, sepse ka raste që faktet që duhet të vërtetohen në çështjen, zbulohen mbi bazën e ekzaminimeve të kryera para fillimit të çështjes penale. Në këto raste ekspertimi realizohet nga personi përkatës zyrtar, duke plotësuar kërkesat e administratës, pa pasur personi që e kryen atë, të drejta dhe detyrime procedurale. Në praktikë dhe në teori ka raste që ky ndryshim thelbësor midis ekspertimit gjyqësor dhe ekspertimit të një ministrie apo institucioni, nuk mbahet në konsideratë, por përsëritet nga prokurori ose gjykata në gjykimin e çështjes, si kur pranohet kërkesa për pavlefshmëri ekspertimi, ashtu dhe kur kryerja e ekspertimit lind gjatë gjyqimit dhe ajo vendos ta caktojë atë.

Ekziston mendimi që, në qoftë se konkluzioni është formuluar mbi bazën analizës së të dhënave të realizuara para fillimit të çështjes penale, nga punonjësi ekspert i institucionit ose nga specialistë të tjerë kompetentë, në raste të tilla organi i procedimit penal çlirohet nga detyra e caktimit të ekspertimit. Mendojmë se kjo pikëpamje nuk është e drejtë, për këto arsye:

Së pari, se specialisti nuk mund ta realizojë ekzaminimin në atë vëllim që nevojitet, për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, kur para tij nuk janë formuluar dhe parashtruar për zgjidhje pyetjet konkrete, nga organi i akuzës apo nga i pandehuri me mbrojtësin e tij, në zbatim të një procesi të rregullt ligjor, duke respektuar të drejtat e pjesëmarrësve në procedimin penal të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, në marrjen e kësaj prove. Në këtë drejtim Kodi i Procedurës Penale i Francës, ndër kode të tjera të procedurës penale, edhe pse parashikon ekspertimet e kryera në veprimet e para prej policisë, kur ajo është vënë në dijeni për një ngjarje të ndodhur, i ka dhënë të drejtën prokurorit, ta përsërisë ekspertimin edhe një herë.

Së dyti, se mundësia e një specialisti të tillë mbetet kurdoherë e kufizuar, për shkak se rrethanat e çështjes penale janë të njohura, jo nëpërmjet vetë materialit të çështjes, por nëpërmjet personit zyrtar ose personave të tjerë, jo rrallë të interesuar për mënyrën e zhvillimit të hetimit.

Së treti, se duke ekzaminuar materialin që në të ardhmen është objekt shqyrtimi gjyqësor, specialisti, duke përfshirë këtu edhe punonjësit ekspertë të institucioneve, me dashje e vë veten në pozitën e dëshmitarit, që ka perceptuar fakte, jashtë zhvillimit të hetimit, duke përjashtuar kështu mundësinë për të marrë pjesë në çështjen, me cilësinë e ekspertit.

Së katërtri, se një specialist i tillë, duke hyrë në analizën e materialit, nuk ka bërë deklaratën e betimit, para kryerjes së ekspertimit sipas nenit 183 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka asnjë përgjegjësi penale sipas nenit 309 të Kodit Penal,¹⁴) për formulimin e konkluzioneve që dihet se janë të rreme.

Janë pikërisht këto arsye që mendimi i specialisteve të ndërmarrjeve, institucioneve apo dikastereve përkatëse nuk mund të zëvendësojë mendimin e ekspertit, që realizohet nga prokurori ose nga gjykata në rrugë procedurale. Nga pikëpamja e klasifikimit të provave, mendimi i një specialisti të tillë formon në çështjen një provë shkresore, në një kohë që, mendimi i ekspertëve është një mjet i pavarur i të provuarit dhe provë, në kuptimin e nenit 149 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Duke parë zhvillimin dinamik të jetës, intensitetin e përparimit shkencor, ngritjen e aftësive të kriminelëve që implikohen në vepra penale dhe rrezikshmërinë që paraqet kriminaliteti i organizuar, për të bërë një luftë sa më efektive ndaj tij, edhe në kuadrin aktual të reformimit të legjislacionit në përgjithësi dhe në veçanti atij procedural penal, Kodi i Procedurës Penale duhet të plotësohet, duke përcaktuar rastet, kur ekspertimi duhet të jetë i detyrueshëm.

Referenca

1. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore të Shqipërisë.
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
4. Kodi i Procedurës Penale i Francës.
5. Kodi i Procedurës Penale i Zvicrës.
6. Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë.
7. Kodi i Procedurës Penale i Italisë.
8. Kodi i Procedurës Penale i Greqisë.
9. Kodi i Procedurës Penale i Rusisë.
10. Kodi i Procedurës Penale i Bullgarisë.
11. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.
12. Charles e O'Hara e Gregori L'O'hara "Fundamentals of Criminal Investigation", f. 521, 523.
13. Jean Pradel, Procedura Penale, Paris 1992, f. 393.
14. Kodi i Procedurës Penale i Bullgarisë.